



## **SYLLABUS I LËNDËS “Inxhinieringu i pyjeve”**

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti i Shkencave të Jeta dhe Mjedisit</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Inxhinieringu i pyjeve</b>
<b>Programi:</b>	<b>Shkencat e pyjeve dhe Mjedisit</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Zgjedhore</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>Viti i dytë, Semestri i dytë</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>2+1</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>3</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>Do shpallet</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof. Asoc.Dr. Ylli Kortoçi</b>
<b>Të dhënat kontaktuese:</b>	<b>E-mail:ylli.kortoci@uni-prizren.com; Mob.+38345846817</b>
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	<p>Në modulën e “Inxhinieringu i pyjeve” trajtohen tema të cilat i vijne në ndihmë përgatitjes së studentëve si teknikien të ardhshëm të mbareshtrimit të qendrueshëm të pyjeve dhe mjedisit në teresi. Qarkullimi dhe trafiku në pyje. Zhvillimi historik i trafikut pyjor dhe qarkullimit pyjor. Karakteristikat e trafikut pyjor. Ngarkesa e trafikut dhe cilësia e transportit. Grafikimi i ngarkesës pyjore dhe transporti i qarkullimit pyjor. Profili gjatësorë dhe faktorët gradient gjatësorë. Tërthorizimi ideal maksimal gjatësorë. Kursi i pjerrtësisë gjatësorë dhe gradientit ekuivalent. Formësimi i pjerrtësisë gjatësorë, pikat e pushimit-ndalesës. Formësimi dhe elementet e kurbës vertikale. Profilet kryqëzore të komunikimi-qarkullimit pyjor. Format bazike dhe speciale të profileve kryqëzore. Faktorët e gjerësisë të shtresave të ulta të rrugëve. Kapaciteti trafikor i rrugëve pyjore. Elementet e linjës qendrore të rrugës pyjore. Rrugët me leqë. Puna konstruktive për shtresën e ulët të rrugës. Konstruksioni për shtresën e sipërme të rrugës. Rrugët pyjore në bazën shkëmbore jo stabile. Mirëmbajtja e rrugëve pyjore. Procedurat e mirëmbajtjes, organizimi dhe puna e mirëmbajtjes. Sigurimi i transportit nëpër rrugët pyjore dhe kategorizimi i rrugëve pyjore. Standardet e mirëmbajtjes. Rrugët pyjore në pronat pyjore private.</p>
<b>Qëllimi i lëndës:</b>	<p>Qëllimi i lëndës “Inxhinieringu I pyjeve “ është të familiarizojë studentët me bazat kryesore të mberritshmerisë pyjore, ndertimin e rrugëve pyjore dhe mirëmbajtjen pyjore, veprat e artit në rrugët pyjore, urat, dhe domosdoshmerinë e tyre në punimet pyjore.</p>
<b>Rezultatet e të nxënës:</b>	<p>Nëpërmjet programit të “Inxhinieringu i pyjeve” studentët do të marrin informacionin e nevojshëm në:</p>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mbërritshmerinë e pyjeve.</li> <li>➤ Studimi i mbërrejtshmerisë në një njesi menaxhuese.</li> <li>➤ Ndikimi i mbërritshmerisë në punimet silvikulturale.</li> <li>➤ Ndikimi i mbërrejtshmerisë në shfrytëzimin e pyjeve.</li> </ul> <p>Meremetimet e rrugëve dhe mirmbajtja. etj.</p>		
<b>Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në terren	-	-	-
Kollokfiume, seminare	-	-	-
Detyra të shtëpisë	-	-	-
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	5	5
Përgatitja përfundimtare për provim	1	5	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	1	5	5
Projektet, prezantimet ,etj	-	-	-
<b>Totali</b>			<b>75 orë (3 ECTS)</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata, diskutime, ushtrime laboratorike, ekspedita, konsultime, seminare, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kolokviume, detyre kursi, provime.		
<b>Metodologjia e vlerësimit:</b>	Vlerësimi i parë (kolokvium): 15%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 5%, Provimi final: 70%, Total: 100%.		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura primare:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kotro M. 2006. Mbërritshmeria e pyjeve.</li> <li>• Potocnik, I., 2003. Forest road formation ëdith as an indicator of human impact on forest environment. Ekologjia (Brtisl.).</li> </ul>		

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Potocnik,I., 1998. The environment in planning a forest road network. Forestry Sciences. Vol.54. Dordrecht; Boston, London: Kluwer Academic Publishers.</li> <li>• Mbërritshmeria dhe Shfrytëzimi i Pyjeve . Mihallaq Kotro. Panajot Koci. (2000).</li> <li>• FAO. Model Code of Forest Harvesting Practices (1996).</li> <li>• Giovanni Hipoliti “ Le utilizzazioni Forestali” (1990).</li> <li>• Kortoçi,Y.,Kellezi, M. (2012):Shfrytëzimi i pyjeve të ahut të Shqipërisë me një silvikulturë të qëndrueshme.</li> </ul>
<b>Literatura shtesë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Luciano Martarello, Arturo Millesi, Renzo Rey, Nevio Yeullaz, Giancarlo Zorzetto Struttura forestazione e sentieristica - Regione Autonoma Valle d’Aosta (Quart).</li> <li>• Ruggero Marazzato, Tiziano Martin – Settore Gestione Proprietà Forestali. Regionali e Vivaistiche – Regione Piemonte (Vercelli).</li> </ul>

<b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b>		
<b>Java</b>	<b>Ligjërata</b>	<b>Ushtrime</b>
<i>Java e parë:</i>	Mbërritshmëria e pyjeve , “inxhinjeringu pyjor”. Historik i shkurtër mbi rrugët pyjore.	Praktike në terren për metodikën e punës në zgjedhjen e transhese së rrugës pyjore.
<i>Java e dytë:</i>	Infrastruktura rrugore dhe mjedisi pyjor. Terreni i rrugëve pyjore, mjedisi ku ato ndërtohen.	Rrugët pyjore , nderhyrjet në punët komplekse të ndërtimit të tyre.
<i>Java e tretë:</i>	Efektet e Inxhinjeringut pyjor , në punimet pyjore dhe efikasiteti i saj për arritjen e qëllimeve.	Mbërritshmeria në rrugë tokësore, rrugët automobilistike, pistat natyrore.
<i>Java e katërt:</i>	Ngarkesa e trafikut dhe cilësia e transportit. Grafikimi i ngarkesës pyjore dhe transporti i saj.	Rrugët artificiale të traktoreve, skema teknologjike e ndërtimit të këtyre rrugëve.
<i>Java e pestë:</i>	Planifikimi dhe dëndësia e rrjetit rrugor. Sa është dhe sa duhet të jetë përqindja e rrugëve pyjore.	Strategjitë e shërbimit ndaj pyllit, me rrugë auto, hapja e rrugëve për nderhyrje kundër zjarreve.
<i>Java e gjashtë:</i>	Parametër bazë të projektimit të rrugëve . Punimet e zyrës, projektimi i rrugës në hartë dhe projektimi në terren.	Infrastruktura rrugore dhe mjedisore, ndikimi i rrugës në mjedisin pyjor.



<i>Java e shtatë:</i>	Rrjeti rrugor dhe mjedisi pyjorë. Pistat, skelat e ngarkimit, pjerrësia e terrenit, etj.	Rroli shumëfunksional i rrugës auto në binomin pyll rrjet rrugor.
<i>Java e tetë:</i>	Normativat e projektimit të rrugëve pyjore. Norma ditore, punimet me akord, procese kontrollit etj.	Veçoritë e rrugëve pyjore, klasifikimi i tyre sipas largësisë nga qendrat rurale.
<i>Java e nëntë:</i>	Ndëtimi i rrugëve pyjore. Punimet bruto të tipit të rrugës, vëllimi i punës, mjetet e nevojshme.	Faktorët dhe elementet ndikues në shtrirjen e rrjetit rrugor pyjorë.
<i>Java e dhjetë:</i>	Punimet bioinxhinjerieke. Sigurimi i qëndrueshmërisë të trupit të rrugës.	Bazat praktike të përcaktimit të shkallës së shërbimit të pyllit nga rruga auto.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Ndërtimi i platformës së rrugës. Ndërtimi i kanaleve, gjatësore, terthorë, dranazhues.	Praktikatat e mberritshmërisë dhe dendësisë në shtrirjen e rrugëve auto.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Elementet e linjës qendrore të rrugës pyjore, veprat e artit. Urat, muret anësore, pritaretj.	Parimet bazike të projektimit të rrugëve pyjore, punimet e zyrës, punimet e terrenit.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Sigurimi i transportit nëpër rrugët pyjore dhe kategorizimi i rrugëve pyjore.	Klasifikimi dhe përmasat e rrugëve pyjore, kodet e menaxhimit për ndërtimin e rrugëve.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Sistemet e afrimit dhe nxjerrjes së materialit drusor nga pyjet. Rrugët dhe pistat e grumbullimit.	Shembuj aplikativ të rrugëve të brendshme të afrimit të lëndës me traktor.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Standardet e mirëmbajtjes. Mermetim mirëmbajtja e rrugëve pyjore.	Mjetet dhe mekanizmet, për punimet rrugore. Buldozeri, skreperi, greideri etj.

### Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjëratat, marrin pjesë në vizita studimore në terren (ekskursion). Shkyçja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit dhe mbajtja e qetësisë në mësim po ashtu janë obligative.